



## DEKLARATË E DELEGACIONIT PARAZGJEDHOR TË NATIONAL DEMOCRATIC INSTITUTE NË SHQIPËRI

*Tiranë, 21 Prill 2005*

### I. PREZANTIM

Kjo deklaratë ofrohet nga një delegacion parazgjedhor ndërkombëtar i organizuar nga National Democratic Institute for International Affairs (NDI), në vigjilje të zgjedhjeve parlamentare shqiptare të 2005. Delegacioni i NDI vizitoi Shqipërinë nga data 17 prill deri në datën 21 prill dhe u takua me udhëheqës politikë, qeveritarë dhe të shoqërisë civile, sikurse edhe me përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare.

Shqipërisë ende i mbetet të kryejë një proces zgjedhor që të arrijë plotësisht standardet ndërkombëtare për të cilat vendi është angazhuar. Zgjedhjet e shkuara janë dëmtuar prej keqadministrimesh politike, gabimesh administrative dhe aplikimit përzgjedhës të ligjeve zgjedhorë. Një proces zgjedhor i përmirësuar dukshëm dhe plotësisht në linjën e standardeve ndërkombëtare do të çojë përpara tranzicionin demokratik të vendit. Ai do të fuqizojë bazën politike për qeverisje demokratike, dhe fuqizojë nivelin e dialogut ndërmet qeverisë dhe qytetarit dhe ta çojë vendin përpara drejt anëtarësimit në NATO dhe BE. Pra, ka shumë gjëra që mund të humben ose fitohen.

Qëllimet e këtij vlerësimi janë që të shprehin mbështetjen për një proces zgjedhor të vërtetë demokratik; të vlerësojë kushtet zgjedhore dhe mjedisin politik në të cilin do të mbahen zgjedhjet e ardhshme; dhe të ofrojë gjetje të paanshme mbi situatën parazgjedhore. Vlerësimi u realizua sipas standardeve ndërkombëtarë për vëzhgimin jo-partiak të zgjedhjeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe pa ndërhyrë në procesin zgjedhor. Delegacioni nuk ka për qëllim të japë një vlerësim përfundimtar dhe të plotë të procesit zgjedhor për arsye se zgjedhjet nuk janë mbajtur ende. Në të vërtetë është populli i Shqipërisë që si qytetar dhe votues do të përcaktojë besueshmërinë e zgjedhjeve.

Periudha parazgjedhore është kritike për të kuptuar dhe vlerësuar shkallën në të cilën zgjedhjet janë demokratike. Sidoqoftë, një vlerësim përfundimtar dhe i plotë i çdo zgjedhjeje duhet që të marrë parasysh të gjithë aspektet e procesit zgjedhor: kuadrin ligjor zgjedhor; kontekstin politik përpara dhe gjatë fushatës; proceset e votimit dhe të numërimit të votave; shpalljen e rezultateve; hetimin dhe zgjidhjen e ankesave; dhe të gjithë kushtet që rrethojnë zbatimin e rezultateve.

## II. VËZHGIME TË PËRGJITHSHME

Në mënyrë që të mbajë zgjedhje që reflektojnë standarde zgjedhore ndërkombëtare, zyrtarët zgjedhorë dhe gjyqësorë duhet të aplikojnë ekspertizë teknike dhe autoritet ligjor në një mënyrë rreptësisht jo-partiake. Udhëheqësit politikë duhet të demonstrojnë vullnet politik dhe konsensus – përmes veprimit dhe jo vetëm retorikës – për të kryer fushata paqësore të lidhura me interesat e votuesve. Ata duhet të parandalojnë praktikat korruptive të tilla si ndryshimin e listave të votimit, mbushjen e kutive të votimit, përdorimin e burimeve financiare të paligjshme dhe votimin alternativ jo të duhur, dhe të përdorin praninë e tyre në organet zgjedhore për të zbatuar ligjin dhe procedurat administrative. Qytetarët si individë dhe grupet qytetare duhet të marrin mbi vete me përgjegjësi detyrën e tyre si votues dhe vëzhgues.

Delegacionit i bëri përshtypje njohja prej të gjitha palëve e rëndësisë sipërore që ka zhvillimi i zgjedhjeve demokratike. Në të njëjtën kohë, delegacioni ndan shqetësimet që iu shprehën se momentalisht procesi zgjedhor është më i tepër i ndikueshëm sesa i mbrojtur siç duhet prej korrupsionit i cili do të minonte integritetin e tij. Veç kësaj procedurat e reja zgjedhore mundet që të krijojnë konfuzion administrativ që do të provokonte tension politik. Delegacioni vëren praninë në rritje të aktorëve joqeveritarë, jopartiakë në procesin zgjedhor si një ndikim i shëndetshëm në zhvillimin e përgjithshëm të zgjedhjeve.

Më poshtë, delegacioni shënon zhvillime pozitive që mund të çojnë drejt zgjedhjeve demokratike dhe gjithashtu nënvizon sfidat që duhet të adresohen për të nxitur besimin e publikut në procesin zgjedhor.

## III. GJETJE

- Megjithëse në një atmosferë politike të polarizuar, dy partitë më të mëdha politike kanë gjetur gjuhën e përbashkët në elementë kyç të procesit zgjedhor: ndryshimet në kodin zgjedhor, caktimi i zonave zgjedhore dhe procedurat e hartimit të listës së votuesve. Kjo formë bashkëpunimi mund të shtrihet në organet zgjedhore të cilat këto parti do t'i mbizotërojnë efektivisht, duke ndihmuar në zbutjen e konfliktit i cili në zgjedhjet e mëparshme ka çuar në incidente të dhunshme, dhe mundësisht të sigurojë një masë të rëndësishme stabiliteti. Sidoqoftë, përveç ngritjes së një komisioni parlamentar për t'u marrë me çështjet e reformës të ligjit zgjedhor, procedura zgjedhore rrjedhuese i'u akordon dy partive më të mëdha kontroll të qenësishëm, në kurriz të një konsensusi shumëpartiak me bazë të gjerë që reflekton parimin demokratik të përfshirjes.
- Shqetësimet kronike në lidhje me integritetin e listave të votuesve janë ende ekzistente. Vendimi për të decentralizuar përgjegjësinë e hartimit të listave të votuesve prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tek drejtuesit e njësisive të pushtetit vendor, ka paraqitur procedura të reja relativisht afër ditës së parashikuar të zgjedhjeve. Ngërçi politik për angazhimet financiare dhe konfuzioni në lidhje me zbatimin, kanë vonuar veprimtarinë edhe më tej. Pa një vullnet politik të mjaftueshëm ndryshimi i listave dhe gabimi

administrativ ende mund të zgjasin vonesat dhe të çojnë në mohimin e të drejtës së votimit për zgjedhësin si dhe votimin e shumëfishtë.

- Ekziston një shqetësim i gjerë në lidhje me një taktikë zgjedhore me anë të së cilës një parti e madhe udhëzon mbështetësit që votën e listës proporcionale t'ia japin një partie më të vogël të afërt, dhe në këmbim mbështetësit e kësaj partie do të votojnë kandidatin e partisë së madhe në listën maxhoritare. Qëllimi është maksimalizimi i mundësive për partinë e madhe që të formojë një qeveri duke rritur numrin e vendeve për partitë aleate. Ndërsa kjo taktikë, mund të mos shkelë kodin elektorale apo Kushtetutën, nëse realizohet, ajo mund të tjetërsojë ndarjen e vendeve parlamentare në një mënyrë të tillë që do të shtrembëronte përfaqësimin e elektoratit në parlament dhe do të minonte besueshmërinë e parlamentit.
- Një ndryshim në kodin elektorale, që zhvendos procesin e numërimit të votave nga secila prej afërsisht 4700 qendrash votimi në Shqipëri në qendra të reja numërimi në secilën prej 100 zonave zgjedhore, ngrre shqetësimin e keqadministrimit të mundshëm në formën e prekjës së kutisë së votimit gjatë transportimit me automjete nga qendra e votimit në qendrën e numërimit. Ka gjithashtu shqetësime se partitë politike mund të caktojnë ose zëvendësojnë numëruesit e tyre të votave deri në dy orë përpara mbylljes së votimeve, duke lënë kohë të pamjaftueshme në dispozicion për të trajnuar disa mijëra individë të tjerë si numërues votash. Megjithëse ligji elektorale parashikon që i gjithë numërimi duhet të përfundojë në orën 17.00 të ditës pasardhëse, provat eksperimentale tregojmë se do të duhet shumë më tepër kohë për të përfunduar numërimin në 100 zonat zgjedhore.
- Ekzistojnë faktorë sistemorë dhe tradicionalë që shfajorizojnë gratë që kërkojnë të jenë kandidate, që të shërbejnë në komisionet zgjedhore, madje që edhe të votojnë. Në veçanti, delegacioni është i shqetësuar për praktikën jologjore të të ashtuquajturit votim familjar, me anë të së cilit kryefamiljari mashkull merr përsipër të votojë për/ose të ndikojë padrejtësisht, votat e anëtarëve të tjerë të familjes, përfshirë këtu gratë dhe ata që nuk banojnë në vend. Delegacioni nënvizon të drejtën kushtetuese të të gjithë votuesve të aftë për të votuar – burra dhe gra – që të votojnë në mënyrë të pavarur sipas ndërgjegjjes së tyre individuale.
- OJQ-të shqiptare po ndihmojnë votuesit të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të ngrenë besimin publik në procesin zgjedhor. Grupet qytetare në nivel vendor po përgatisin 'platforma zgjedhore' dhe debate me kandidatët vendorë nëpërmjet të cilave qytetarët të mund të përfshijnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë përfaqësuesit e tyre të ardhshëm në çështjet e komunitetit. Të tjerë, po edukojnë votuesit që të kontrollojnë listat e votuesve dhe po monitorojnë median. Grupe qytetare nën siglën e Koalicionit Shqiptar Kundër Korrupsionit po marrin përsipër një vëzhgim jopartiak të më shumë se gjysmës së qendrave të votimit në vend, dhe të gjithë 100 qendrat e numërimit të votave. Ky koalicion po përpiqet të inkuadrojë, trajnojë dhe caktojë disa mijëra qytetarë vëzhgues të cilët do të jenë të aftë të vlerësojnë procesin e votimit dhe të numërimit të votave në mënyrë cilësore dhe të paanëshme sipas ligjit vendas të zgjedhjeve dhe standardeve ndërkombëtare.

#### IV. REKOMANDIME

Të gjithë aktorët në procesin zgjedhor – shtetërorë, politikë, qytetarë, gjyqësorë dhe individë – duhet të bashkëpunojnë për të arritur qëllimin e deklaruar të vendit për zgjedhje demokratike. Institucioni qendror ku ndërlidhen të gjithë këta aktorë është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe është në interesin e Shqipërisë që ky organ të lejohet të funksionojë sipas ligjeve dhe parimeve të ndershmerisë, përfshirjes dhe transparencës.

- Partitë politike duhet të sigurojnë elektoratin për zotimin e tyre për të zbatuar parimet demokratike, etikën e shëndoshë dhe sundimin e ligjit në sjelljen e tyre elektorale. Për këtë qëllim, delegacioni me plot respekt ofron masat e mëposhtme për ‘ndërtimin i besimit’:
  - Partitë duhet të sigurojnë vetveten dhe elektoratin se kandidatët e tyre nuk kanë interesa private ose biznesi që ngrenë shqetësime për korrupsion dhe shkelje të tjera etike të cilat do të kompromentonin besueshmërinë e tyre si zyrtarë të zgjedhur për të respektuar sundimin e ligjit;
  - Partitë politike aktualisht po shqyrtojnë një kod të sjelljes në zgjedhje. Partitë duhet të zotohen karshi këtij kodi, të edukojnë përfaqësuesit e tyre për përmbajtjen e tij dhe ta përdorin kodin për të nxitur dhe demonstruar konsensus në lidhje me një sjellje që i shkon për shtat një procesi zgjedhor demokratik;
  - Partitë duhet të sigurojnë se përfaqësuesit e tyre në qendrat e votimit dhe në komisionet zonale të votimit si dhe në skuadrat e numërimit të votave, të jenë të informuar për procedurat përkatëse, të parandalojnë aktet joligjore dhe korruptive dhe të respektojnë interesin publik për sa i përket saktësisë dhe transparencës, në vend që t’u shërbejnë interesave partiake; dhe
  - Gjatë periudhës zgjedhore, partitë nuk duhet të ndërmarrin veprime që ndikojnë padrejtësisht zgjedhjen që bën votuesi, duke përfshirë udhëzimin e mbështetësve për të votuar për parti të tjera me qëllim avantazhin taktik.
- Shteti, pushteti vendor, dhe aktorët politikë duhet të marrin masa të menjëhershme për të siguruar përpilimin e duhur dhe të saktë të listave të votuesve.
  - Duhet të mbështeten plotësisht programet e edukimit të votuesve për të rishikuar listat e votuesve dhe për metodat e këtij rishikimi;
  - Drejtuesit e njësive të pushtetit vendor duhet të pajisin qytetarët në kohë me listat e publikuara dhe të sigurojnë që qytetarët janë të informuar në lidhje me vendndodhjen e qendrave të tyre të votimit; dhe
  - Një komision shqyrtues shumëpartiak duhet të mbikëqyrë verifikimin në bazë kombëtare të listave provizore të votuesve të hartuara nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Skuadrat e ekspertëve shumëpartiakë duhet të verifikojnë një për një listat e atyre njësive vendore që nuk janë aktualisht në përputhje me procedurën dhe të shqyrtojnë plotësisht ato lista që shfaqin mospërputhje.

- Procedura e re e numërimit të votave do të forcohej duke lejuar vëzhguesit jopartiakë të egzaminonin nga brenda automjetet përpara se këto të fundit të transferojnë kutitë e votimit dhe materialet e votimit. Komisionet zonale duhet të sigurojnë që vëzhguesit ndërkombëtarë dhe ata jopartiakë vendas, përfaqësuesit e medias dhe vëzhguesit e partive politike të kenë hyrje të pakufizuar në vëzhgimin e procesit të numërimit të votave. Autoritetet zgjedhore, partitë politike dhe media duhet të përgatisin elektoratin për vonesa të mundshme në raportimin e rezultateve përfundimtare jozyrtare në qoftë se procesi i numërimit të votave zgjatet përtej afatit të specifikuar në kod.
- Përpjekjet për edukimin publik për të luftuar ‘votimin familjar’ duhet të mbështeten me fonde plotësisht nga shteti si dhe të mbështeten nga të gjithë aktorët zgjedhorë. Përfaqësuesit e komisioneve të qendrave të votimit duhet të përmbushin detyrimin e tyre kushtetues për të ndaluar çdo rast në të cilin një individ voton për një individ tjetër, veç rasteve kur kjo është e autorizuar me ligj.
- Si pjesë e kësaj hyrjeje të plotë në të gjithë fazat e procesit zgjedhor, vëzhguesit vendas jopartiakë duhet të kenë të drejtën të marrin kopje të procesverbaleve të qendrës së votimit dhe qendrës së numërimit të votave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të zgjidhë paqartësitë që kanë të bëjnë me numrin e vëzhguesve vendas jopartiakë të lejuar në qendrat e numërimit të votave.
- Përgjegjësia e votuesit nuk bie vetëm mbi ditën e zgjedhjeve por përgjatë gjithë periudhës zgjedhore. Qytetarët duhet të kontrollojnë emrat e tyre në listat paraprake të votuesve të afishuara në lagjet e tyre. Ata duhet të ndjekin debatet e kandidatëve dhe të jenë pjesë e ambjentëve të tjera në të cilat të mund të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me ata që po i’u kërkojnë votën. Ata duhet të jenë të vullnetshëm për të marrë pjesë në edukimin e votuesve dhe në përpjekjet për vëzhgimin e zgjedhjeve. Dhe sigurisht ata duhet që të votojnë.

## V. DELEGACIONI DHE PUNA E TIJ

National Democratic Institute filloi programin e tij në Shqipëri në vitin 1991, duke ndihmuar Shoqatën për Kulturë Demokratike, një organizatë qytetare Shqiptare për monitorimin e zgjedhjeve; duke mbështetur zhvillimin dhe reformën e partive politike të të gjithë spektrit politik; dhe duke përfshirë qytetarët në mbarë Shqipërinë në edukimin qytetar, në gjenerimin e punës përkrahëse. NDI-së momentalisht i është bashkuar Partners Albania dhe IREX, në programin për Demokraci dhe Qeverisje, mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, program i cili synon zhvillimin e mëtejshëm demokratik në nivel lokal dhe kombëtar përmes nismave qytetare, zgjedhore, mediatike, të partive politike dhe legjislative të cilat nxisin pjesëmarrjen publike dhe reduktojnë praktikën korruptive.

NDI ka organizuar afërsisht 100 misione vëzhgimi parazgjedhore dhe zgjedhore në të gjithë botën në 20 vitet e fundit, përfshirë shumë të tilla në Europën Qendrore dhe Lindore. Instituti ka monitoruar 8 zgjedhje parlamentare dhe lokale në Shqipëri që

prej vitit 1991. Gjetjet e këtij misioni parazgjedhor në tërësinë e tyre pasqyrojnë vetëm pikpamjet e këtij delegacioni dhe të National Democratic Institute.

Ky delegacion përbëhet nga Karan English, ish Anëtare e Kongresit të Shteteve të Bashkuara nga Shteti i Arizonës; Peter Hack, ish Anëtar i Parlamentit Hungarez; dhe Robert Benjamin, Drejtor Rajonal i NDI për Europën Qendrore dhe Lindore, të gjithë këta, pjesëmarrës në vlerësime të tjera parazgjedhore të NDI - së. Delegacionit iu bashkua Jennifer Butz, Drejtoreshë Vendore NDI / Shqipëri, dhe Dan Redford, Menaxher i Lartë Programi, NDI / Shqipëri. Delegacioni u ndihmua me aftësi nga Elton Stefani, Guri Daco dhe Blerim Dimni, të cilëve u shpreh mirënjohjen e tij.

Për vëzhgimet dhe gjetjet e tij, delegacioni u bazua mbi një analizë të kuadrit ligjor për zgjedhjet parlamentare; shqyrtim të materialeve mbi procesin zgjedhor shqiptar të përgatitura nga organizata të tjera ndërkombëtare dhe grupe qytetare shqiptare; dhe analiza të informacionit të prezantuar gjatë takimeve të kësaj jave të delegacionit. Delegacioni pati kënaqësinë që të takohej me udhëheqës të lartë të partive politike të mbarë spektrit politik, përfaqësues të lartë të bashkësisë ndërkombëtare, analistë të medias dhe grupe joqeveritare. Delegacioni u prit ngrohtësisht nga të gjithë bashkëbiseduesit dhe u shpreh atyre mirënjohjen e tij të thellë për shkëmbimin e pikëpamjeve dhe kushtimit të kohës së tyre.

## **VI. PËRFUNDIM**

Aftësia e Shqipërisë për të kryer zgjedhje parlamentare demokratike, aktualisht, varet në parim nga aftësia e aktorëve qytetarë, politikë dhe zgjedhorë për të minimizuar mundësinë e keqadministrimit. Nëse lindin mosmarrveshje, niveli i ndershmërisë, transparencës dhe i llogaridhënies së demonstruar, respektimi i ligjit i cili zbatohet në mënyrë të plotë dhe të saktë, dhe angazhimi për zgjidhje paqësore—do të jetë i një rëndësie madhore.

Në fund të fundit, votuesi shqiptar është aktori më i rëndësishëm në këto zgjedhje. Delegacioni shpreson se qytetarët do ta konsiderojnë procesin zgjedhor të vlefshëm për besimin e tyre. E gjithë kjo duhet kryer nga zyrtarët zgjedhorë, udhëheqësit politikë dhe vëzhguesit, dhe gjykatësit duhet t'i shërbejnë besimit publik, i cili gjendet tek çdo votues që merr përsipër përgjegjësinë qytetare për të hedhur votën e tij/saj dhe që në këmbim pret që kjo votë të respektohet si çështje zgjedhjeje individuale.

Në një mjedis zgjedhor kundërshtues si ky që ekziston në Shqipëri, parimi bazë i demokracisë mund të lihet pas dore. Tranzicioni premtues demokratik i Shqipërisë do të përparojë ndjeshëm atëherë kur interesat politikë të përputhen dhe jo të minojnë interesin publik. Delegacioni shpreson se zgjedhjet e ardhshme parlamentare të përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në këtë aspekt.